

VENDIM
Nr.630, datë 14.9.2011

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT QENDROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15 e 56 të ligjit nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Qendror organizohet si institucion qendror, pa degë në territor.
 2. Inspektorati Qendror drejtohet nga Inspektori i Përgjithshëm dhe organizohet në drejtori dhe sektorë për kryerjen e funksioneve të parashikuara në ligjin nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
 3. Inspektori i Përgjithshëm emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, sipas procedurave të parashikuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit”.
 4. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Inspektoratit Qendror është 12 (dymbëdhjetë) dhe përballohet nga rialokimi dhe reduktimi i 2 (dy) pozicioneve në ministritë e mëposhtme:
 - Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
 - Ministria e Punëve Publike dhe Transportit;
 - Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
 - Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
 - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
 - Ministria e Shëndetësisë.
 5. Inspektorati Qendror identifikohet me stemën dhe vulën e tij zyrtare.
 6. Fondet për shpenzime korente, në shumën 2 000 000 (dy milionë) lekë, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 7. Ngarkohet Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ministritë e përmendura në pikën 4 për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha